

*Specialist (Profili Shoqëror)/Sektori i Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare, Zhvillimit Strategjik dhe Identifikimit, Drejtoria e Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike*

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 141 datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 12.12.2022 “Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK”, i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 233, datë 20.12.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike” dhe urdhrin të Kryeministrit nr. 36, datë 19.02.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 233, datë 20.12.2023”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1(një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist (Profili Shoqëror)/Sektori i Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare, Zhvillimit Strategjik dhe Identifikimit, Drejtoria e Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike:**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- Identifikon dhe klasifikon nëpërmjet metodologjisë dhe indikatorëve, infrastrukturën e reja të informacionit në kritike dhe të rëndësishme.
- Drafton strategjinë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planin strategjik që e shoqëron atë, duke bashkëpunuar me institucionet e sigurisë, sipas prioriteteve të fushës.
- Mban korrespondencë me infrastrukturën nëpërmjet pikave të kontaktit dhe në çdo kohë ndërvepron për rivlerësimin dhe klasifikimin e infrastrukturave të informacionit.
- Merret me kërkim për thirrje projektesh dhe implementimin e tyre për nevoja të institucionit.
- Merret në vazhdimësi me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit sipas sektorëve dhe grupeve të interesit në lidhje me objektivat e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike.
- Siguron ndihmë metodike dhe procedurale kur i kërkohet, strukturave të tjera të Autoritetit.

- Me miratimin e eprorit kryen detyra të veçanta në ndihmë të sektorëve të tjerë, si dhe merr pjesë në grupe të ndryshme pune, komisione, konferenca kombëtare e ndërkombëtare duke përfaqësuar Autoritetin.

## **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

**Arsimi:** Niveli minimal i diplomës “Master Profesional” në **Shkenca Juridike/Shoqërore**.

**Përvoja:** Të ketë jo më pak se 2 vite pune në profesion.

### **FUSHA E NJOHURIVE:**

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 2/2017 Për Sigurinë Kibernetike;
- Ligji 107/2015 Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimeve të Besuara;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale;

Aftësi për të:

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- (Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja;
- Përbën avantazh pajisja me certifikata apo dëshmi të tjera në fushën e sigurisë kibernetike dhe shërbimeve të besuara;
- Njohuri të gjuhës angleze.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-1)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 30.05.2024, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: [burimet.njerezore@cesk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@cesk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);

- Fotokopje të dëshmime të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.